



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 15

Datë: 06. 03. 2020. Ora: 14:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.13/2020;
- 2. Aktivitetet e ZRPP-së:**
 - Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për akreditim e grupit të tretë të vëzhguesve për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës;
 - Shqyrtimi dhe miratimi i vendimi mbi Caktimin e Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për muajin Mars të vitit 2020;
- 3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**
- 4. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**
 - **Këshilli për Operacionet Zgjedhore:**
 - Njoftim për formularët: Formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve, dhe Formularët e rezultateve të dengut;

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020;
- Shqyrtimi dhe miratimi i Këshillave të Vendotimeve për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës;
 - **Këshilli për Çështje Ligjore:**
- Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Pejë dhe Suharekë;

5. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.13/2020:

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve, mirë se keni ardhur në mbledhjen e pesëmbëdhjetë të KQZ-së, e kemi agjendën, a ka vërejtje për këtë agjendë ? Nëse jo, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës, si dhe procesverbalin nr.13 të KQZ-së.

2. Aktivitetet e ZRPP-së:

1. Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për akreditim e grupit të tretë të vëzhguesve për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës:

Yll Buleshkaj: Në këtë javë kemi qenë të zënë me aplikacione për akreditim të vëzhguesve, dhe para jush kemi paraqitur një listë prej 602 vëzhguesve të cilët vijnë nga dy media BIRN dhe Iternës Kosova, nga dy OJQ “IKD” dhe “ORFEU”, një organizatë ndërkombëtare nga Afrika, dhe një parti politike LDK, që i kanë plotësuar kushtet dhe i kanë paraqitur para nesh të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Ne, rekomandojmë që të aprovohet akreditimi i tyre për të vëzhguar zgjedhjet, e po ashtu iu bëjmë thirrje subjekteve të tjera politike që të sjellin listat e vëzhguesve për akreditim sepse, na ndihmojnë edhe neve edhe veten për procedimin e dokumenteve për identifikim me kohë.

Valdete Daka: Para jush e kemi rekomandimin e zyrës për akreditimin e vëzhguesve, kush është për?

Sami Hamiti: Po e shoh këtu një qendër kulturore “Orfeu”, çka ka në statutin e saj, a merret me të drejta, a keni shikuar mirë në statutin e saj...? Nuk kam asgjë kundër, pasi që ka pasur këndeje edhe shoqatë të peshkatarëve, por a e keni shikuar në statut, a i plotëson kushtet për vëzhgim ?

Yll Buleshkaj: Keni të drejtë, por ne kemi shikuar edhe në zgjedhjet e kaluara, nuk e njohim shumë por duket që është aktive pasi që ka paraqitur një listë të madhe të vëzhguesve: 130 !

Arianit Elshani: Edhe unë i bashkëngjitëm komentit të Samiut, të shikohet edhe një herë, ne e kemi të rekomanduar për aprovim por nëse i ka plotësuar kriteret, procedurat ligjore atëherë nuk mund ta ndalim! Por, unë e pashë që në facebook vetëm si qendër kulturore, nuk pashë as ëeb faqe që e rritë kredibilitetin e saj, e bëhet fjalë për 130 vëzhgues që nuk janë pak. Kemi 115 vendvotime në Podujevë, është numër i madh prandaj le të qartësohet kjo...

Valdete Daka: Zyra para se të rekomandoj, i bënë këto të gjitha dhe e merre barrën dhe përgjegjësinë për atë që e rekomandon. Kush është për aprovim? Vazhdojmë me pikën tjetër.

Atëherë, kush është për këtë rekomandim ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të ZRPP-së.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimi mbi Caktimin e Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për muajin Mars të vitit 2020:

Yll Buleshkaj: Për shkak të mos aprovimit të buxhetit të Kosovës apo ligjit për buxhet, ne kemi shkuar me rekomandim që mjetet monetare që ju takojnë subjekteve politike nga ana e fondit të ndahen në baza mujore. Para jush, është paraqitur draft-vendimi për ndarjen e pjesës së tretë por, duke shpresuar nga muajit të ardhshëm do të kemi ligjin e buxhetit të aprovuar, kështu që vendimmarrja të jetë në bazë vjetore, kurse transferimi në baza tremujorë siç, ka qenë më herë. Vërejtja është e njëjtë si në janar, shkurt e mars. Është çështje teknike për t’i transferuar këto fonde tek subjektet publike...

Valdete Daka: Faleminderit Yll, sipas praktikës së deritashme edhe për këto dy muajt e kaluar vazhdojmë deri sa të aprovohet ligji për buxhetin që subjekteve politike t’u ndajmë fondin për mbështetje ashtu siç, është paraqitur, sepse tek kjo nuk kanë ndryshime, janë të njëjta për çdo muaj, varësisht nga ulëset e fituara në parlament. Kush është për këtë rekomandim ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të ZRPP-së.

3.Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:

Yll Buleshkaj: E kemi vendosur si punë praktike që çdo herë kur ka mbledhje të KQZ-së, të bëjmë një përmbledhje të aktiviteteve të sekretariatit se cilat janë realizuar ato më kryesoret gjatë periudhës mes dy mbledhjeve të KQZ-së. Ndërsa, për këshillin e operacioneve zgjedhore kemi përgatitur një raport më të detajshëm. Para jush, vetëm në mënyrë verbale do të tregojmë se të gjitha aktivitetet janë paraparë deri më tani pjesë e planit operacional, dhe jemi në rregull. Më

herët, kanë ndodhur disa vonesa të vogla por tani jemi gjithçka në kohë. Ndoshta një informatë më e rëndësishme, është se fletëvotimet janë shtypur, pritet vetëm transportimi i tyre në fillim të javës së ardhshme nga Sllovenia. E kemi pasur mbikëqyrësin tonë, i cili është siguruar që ato janë shtypur në bazë të kritereve dhe specifikave që i ka miratuar KQZ. Po ashtu, jemi në proces të fillimit të printimit të formularëve zgjedhor, po shpresojmë se jemi siguruar që e kanë cilësinë dhe dizajnin ashtu si duhet. Në aspektet tjera, jemi duke shkuar në hapë me informimin publik i cili, ka pasur në fillim vonesa për shkak mos aprovimit të buxhetit, rrjedhimisht mos zgjedhjes së operatorit ekonomik për ta realizuar informimin publik. Tani, jemi më mirë... Për ata që nuk janë pjesë e informimit publik, ju informojmë se kryetarja e KQZ-së, është aktori kryesor i videos ku qytetarët udhëzohen si të votojnë. Nga analiza që kemi bërë vitin e kaluar, ka treguar që qytetarët kanë dëshirë që të shohin zyrtar sa më të lartë të KQZ-së që u tregojnë atyre në mënyrë më të detajshme se si të plotësohet fletëvotimi...! Edhe me prokurimin, jemi në rregull. Aktualisht, jemi duke i përfunduar 4 aktivitete të prokurimit...

Valdete Daka: A ka dikush pyetje lidhur me aktivitetet e Sekretariatit për këtë njoftim, sepse këtu s'kemi nevojë për ndonjë lloj aprovimi...Nëse jo, vazhdojmë me raportin e këshillave të KQZ-së.

4.Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacionet Zgjedhore:

1.Njoftim për formularët: Formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve, dhe Formularët e rezultateve të dengut:

Alim Rama: Këshilli për operacione zgjedhore, ka marr nga sekretariati formularët e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve FPR-të dhe formularët e rezultateve të dengut. Këshilli nuk ka pasur vërejtjeje dhe mbas kërkesës së sekretariati, i rekomandon për miratim të KQZ-së por, sekretariati mund që të tregojë formularët nëse ka nevojë për anëtarët e KQZ-së !

Valdete Daka: Unë sa po e shikojë në agjendë, është njoftim nga ana e këshillit.

Yll Buleshkaj: Është certifikuar nga ne si i rregullt dhe është arkivuar për nevojat e institucionit për më vonë që nëse hasim në një problem të jetë më lehtë të dimë që nëse ndodhë diçka ku ka ngecur procesi po shkojmë hap pas hapi duke i shtrënguar masat e sigurisë që mos të ndodhin lëshime.

Valdete Daka: Sigurisht, duke u bazuar në eksperiencën e fundit për shkak të atij gabimi në formular tash sekretariati është shumë më i vëmendshëm dhe shpresojmë që mos të kemi gabime të tilla.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020:

Alim Rama: Edhe pse ka ardhur këtu në këshillin për operacione zgjedhore ka pasur debat dhe diskutim por, pasi që ky plan i punës i ngarkon të gjitha departamentet, dhe po ashtu ndoshta ka qenë mirë që secili anëtarë me komentua ndaras se si këshillë, veç e kemi rekomandue për shqyrtim.

Valdete Daka: Ju nuk keni qenë pjesë e KQZ-së, kam qenë vetëm unë Samiu dhe Qemajli duke marrë parasysh që KQZ, në vitin 2018 nuk ka qenë funksionale, në vitin 2019 praktikisht kemi qenë gjysmë viti në zgjedhje parlamentar pak me vonesë por gjithsesi ne kemi arritur të bëjmë një draft plan të planit vjetor të punës së KQZ-së...! Edhe pse këtë vit edhe ky plan është me vonesë, sepse duhet të aprovohet në fund të vitit paraprak për vitin e ardhshëm. Por ne kemi arritur ta bëjmë, edhe pse nuk kemi strategji i cili ka qenë plani strategjik 5 vjeçar...Megjithatë, ne duhet me pas patjetër një plan i punës në bazë të cilit i mbështesim aktivitetet tona pavarësisht që i kemi pas zgjedhjet, pasi që zgjedhjet janë jashtë asaj çka kemi planifikuar, ndërkaq planin e punës duhet ta kemi dhe ta aprovojmë. Sa i përket strategjisë ne mund të diskutojmë dhe të akordohemi që ta përpilojmë një strategji se na duhet patjetër. Ne jemi munduar në një punëtori së bashku me anëtarët e kaluar që kanë qenë pjesë e KQZ-së, dhe me sekretariatit nëpërmjet departamenteve, jemi mundu me zbërthyer dhe me dhënë kontributin tonë, gjithsesi, një plan duhet të ekzistojë, ky është plan për neve për sekretariatit i cili mbikëqyret nga KQZ-ja, janë propozime që edhe krye shefi mundet me shpjeguar diçka...

Yll Buleshkaj: Vetëm pata dëshirë pasi që para anëtarëve të KOZ-it, e kemi shtjelluar temën kurse për antarët e tjerë nuk kemi arrit për shkak që KOZ-i, ka një numër të vogël të anëtarëve, kurse këtu është një numër më i madh por besoj që e kemi dërguar më herët. Besoj që e keni parë edhe ju aktivitetet, ndërsa sot e kemi dërguar edhe planin në mbledhjen e KOZ-it dhe me shumicë votash u aprovua planin e punës për këtë vit. Plani i punës, e ka një numër relativisht të madh të aktiviteteve mbi 70 . Në plan të punës, janë aktivitetet të cilat kemi obligim ligjorë ti përfundojmë, janë aktivitete të cilat Sekretariati së bashku me KQZ-në, i kanë konsideruar të rëndësishëm strategjike për zhvillim të institucionit. Janë bërë të gjitha së bashku, duke i marr në shqyrtim edhe komentet që janë pranuar nga misionet vëzhguese. Ka rastisur që ditën kur është bërë drafti i parë, është publikuar raporti vëzhgues i komisionit evropian, ashtu siç e ka rendin, ne nuk kemi mundur që secilin koment apo rekomandim ta integrojmë për shkak se shumë prej tyre kërkojnë ndryshim të legjislacionit dhe kjo, në fakt ky ndryshim nuk është në dorë të KQZ-së. Por, më shumë përmirësimi i proceseve është në dorën tonë në mënyrë që të kemi zgjedhje më të mira. Disa nga këto aktivitete që janë të listuara me qëllim të përmirësimit të administrimit të zgjedhjeve, besoj do të na ndihmojnë që zgjedhjet e ardhshme të dalin sa më mirë...

Eshref Vishi: Planifikimi, është proces i identifikimit dhe përcaktimit të objektivave dhe i hartimit të procedurave ose operacioneve apo aktiviteteve për arritjen e tyre; Është funksioni i rëndësishëm menaxherial për arritjen në nivelin më të lartë të efikasitetit dhe performancës. Për mendimin tim, ky plan është i ngarkuar, madje i stërngarkuar, ka në vetveten e vet 73 aktivitete të cilat për gjatë këtij viti duhet të përmbushen. Plani ka nevojë të lekturohet, korrigjohet, pavarësisht se është për nevojë të brendshme. Ka shumë përsëritje të cilat e ngarkojnë pa nevojë narrativen e këtij dokumenti të rëndësishëm për KQZ-në. Ne, jemi në proces zgjedhor, dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme i suspendojnë aktivitetet e rregullta planifikuese, andaj besoj se të gjitha

aktivitete e planifikuara për muajit shkurt dhe mars janë shtyrë. Ky plan fillon të zbatohet nga përfundimi ose çertifikimi i rezultateve të zgjedhjeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Podujevë; Tjetra është nëse ka filluar administrata ndonjë aktivitet pa miratim të këtij plani, për mua do të ishte e pa kuptimtë: së pari duhet të miratohet plani, dhe pastaj të fillohet me zbatimin e aktiviteteve planifikuese. Pani, është i bazuar në një dokument strategjik që është i skaduar: fjala është për planin strategjik 2015 – 2018; Është i ngarkuar me përshkrimin e bazës ligjore ku përshkruhen mandatet, kompetencat, përbërja, struktura dhe përgjegjësitë e sekretariatit veç e veç, dhe metodologjia në hartimin e planit. Kjo përmbajtje, ka kuptim veç kur i referohet Kuvendit të Kosovës, gjithë kjo bazë ligjore për përgjegjësit që ushtron Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është i nevojshëm vetëm kur bëhet raportim, pra duhet të hiqen...Sugjerimi im, është që të modifikohet kjo pjesë. Në plan, janë përfshirë dokumentet raportuese që janë përgjegjësi ligjore, që ka plan ose jo, raportimet e tilla rrjedhin domosdo, po i përmendi dy: për shembull: raportimet në KRPP për kontratat e prokurimit, transferet buxhetore për subjektet politike që, i planifikuam apo si planifikuam ne, ato duhet të ndodhin, kështu që për mendimin tim ato nuk duhet të renditen si aktivitete brenda planit të punës! Plotësim – ndryshimi i rregulloreve, si dhe hartimi i të rejave, nuk janë në një aktivitet, por kemi 8 aktivitete të këtilla! Nëse këto hyjnë në një aktivitet, atëherë numri i aktiviteteve të planit duhet të reduktohet. Unë mendoj që duhet të kalojmë nga plani ambicioz, në atë real! Këto janë vërejtjet e mia, dhe mendimi im është që ky plan duhet të rishikohet nga administrata para se të publikohet ky dokument shumë i rëndësishëm për institucionin tonë...

Sami Kurteshi: Edhe unë kam bërë përpjekje për ta rishikuar këtë plan. Më është dërguar, faleminderit... Nuk dua të përsëritëm me atë çka tha kolegu, por cilat janë qëllimet dhe objektivat e planit të cilat nuk vërehen askund! Në përgjithësi, duhet të përshkruhet gjendja, pra cila është gjendja sepse ka aktivitete të cilat nuk dihet se për çka po kryhen: një, cili është qëllimi fillestar ato duhet të operacionalizohen, dhe cila është gjendja ? Edhe një çështje e tretë dhe ndoshta Sekretariati i shpjegon: ka pjesë pa kosto, dhe ka pjesë që kanë kosto. Pyetja ime e parë: hartimi i planit strategjik, është çështje e KQZ-së, ne e kemi obligim, a po...? Ne, duhet ta kemi patjetër një plan...! Cila, është gjendja dhe çka po dëshironi të arrini, thelbi është p.sh., miratimi i planit të trajnimit, nr. 24: "...identifikimi i mungesave të trajnimit të trupave zgjedhore"! Janë dy fusha, dy gjëra i njëjti person i kryen, janë dy gjëra të njëjta: shpenzime, 3000...5000...! Nuk e di pse duhet të përshkruhen si vend pune nga sekretariati, pse duhet KQZ të bëjë shpenzime. Shqyrtimi dhe miratim i ditës globale të zgjedhjeve i cili kushton 5.000 euro! Pse duhet të mbahet kjo...? Si shpenzohen, si...?

Alim Rama: Pajtohem plotësisht me dy parafolësit! Planit i mungojnë objektivat e qarta, plani duhet të ketë objektiva: ka shumë aktivitete që ri përsëriten dhe janë të ngjashme. Këto komente, janë bërë në sekretariat...! Ky plan, ka nevojë që të përpunohet dhe të modifikohet. Analizimi i vendotimeve të rinumëruara të përpunuara në QNR nga zgjedhjet...! Është përshkrim i shkurtër! Ndoshta, është problem madhorë që nuk caktohet cili është ekipi, dhe cila është procedura e punës...!? Janë shumë aktivitete të ngjashme që kanë nevojë të tregojnë cili është kepi përgjegjës që do të merret me atë problem. Njëherë duhet të krijohet strategjia e KQZ-së se ku duam të mbërrijmë, pastaj të bëjmë plan, dhe kur ta bëjmë planin, plani të jetë sa më real! P.sh., pika numër 7: "...analizë për metodat alternative për shënim për votues me ngjyrë të padukshme ose më

artikuluese...!”. Veç një aktiviteti i këtillë, e krijon recepcionin se zgjedhjet në Kosovë janë të degraduara. Në shumicën e shteteve tjera që nuk kanë probleme me zgjedhje, nuk i përdorin ngjyrat, bile edhe i largojnë sepse, ngjyrat e dukshme janë simbol i jo stabilitetit... Unë, në plan nuk pas askund që është bërë një studim impakti në programin aktual...! Gjithmonë ka nevojë për investim, por ku duam të mbërrijmë...

Valdete Daka: Pengesa e juve anëtareve, është që ju nuk keni qenë kur janë diskutuar të gjitha këto sepse këto janë shqyrtuar dhe si finale ka ardhur në plan tani ne në plan mund t’i vendosim. Projektet as objektivat nuk vendosen, ato vendosen në strategji, dhe mbi bazën e strategjisë bëhet plani. Për shembull, te çështja e informimit publik: e kemi një analizë të cilën nuk mund ta vendosim këtu mbi bazën e së cilës, ne kemi propozuar disa aktivitete të cilat kanë rrjedhur si përfundim i asaj analize. Ne tani, nuk mund t’ua shpjegojmë në tërësi, sepse ju nuk keni qenë pjesë e KQZ-së, këtu është problemi i mos kuptimit të planit...

Sami Hamiti: Një pjesë të asaj që desha ta them, ti e the kryetare! Unë, qëllimisht e lashë, prandaj edhe në KOZ kam thënë se jemi të pa barabartë, pra në fazën kur është hartuar ky plan i punës. Është e vërtetë se krye shefi ekzekutiv dhe departamenti ta kompletojnë materialin komplet ashtu siç e kemi pas ne kur e kemi trajtuar atje, pasi nuk është shkruar kjo rastësisht kështu. Tek konceptet e pjesës tjetër qysh hartohet plani...? Objektivat janë në strategji. Ne, tham që nuk kemi strategji sepse, dy vite na kanë kaluar pa mandat. Ato shtylla strategjike janë përdorur si vazhdimësi edhe si kompetenca dhe përgjegjësi që ka KQZ-ja. Edhe me analiza tjera, ne kemi shqyrtuar një përbërje, pjesa tjetër edhe rekomandimet të cilat kanë ardhur nga OSBE, aty ka qenë një zyrtar Bujari, që është njohësi më i miri që e ka OSBE-ja, pra ka qenë një ekip i plotë që e njohin këtë proces. Kërkesë e jonë ka qenë që në hartimin e këtij plani, të jemi shumë më realist, mos ta mbivlerësojmë veten! Secili departament, ka sjell të gjitha pikat që i ka pas: çka ka përfunduar dhe çka jo, dhe çka mund të bartet edhe pse nuk ka pas aktivitete që nuk janë përfunduar. Ne, e kemi ditur që ky vit, nuk do të jetë vit i zgjedhjeve dhe, atëherë kur kemi qenë ne nuk ka pas zgjedhje. Dhe janë planifikuar saktësisht duke u bartur të gjitha në kohë përveç asaj se, çdo tre muaj të raportojnë për pjesën e aktiviteteve që janë përfunduar. Tash, në pjesën e stilit të shkruar dhe stilit tjetër, pajtohemi e s’pajtohemi, por realisht ky plan i aktiviteteve të nxjerra për këtë strategji dhe ka pas një kontribut të madh të të gjithë anëtareve të subjekteve politike me të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe se ato, janë inkorporuar në këtë plan... Planin, mendoj që duhet të aprovojmë, bile jemi vonë...

Çemaili Kurtişi: Mundemi, sigurisht që të japim më shumë por, është ndërtuar aq sa është mundur, dhe janë dhënë propozimet, janë shqyrtuar..! Unë, e mora fjalën për atë se sipas meje, duhet vënë theksin në dy çështje shumë të rëndësishme. Ato, janë të parashikuara këtu, por ato duhet zbatuar me seriozitet: Lista votuese, e cila duhet të jetë e azhurnuar patjetër, dhe të fillohet menjëherë me të gjithë faktorët relevantë...Tjetra, të lehtësohet mundësia e votimit të votuesve nga Diaspora, sepse është shumë me rëndësi që tu mundësohet atyre, dhe të kemi vota nga diaspora për shkak se njerëzit lëvizin vazhdimisht, ka shumë votues në diasporë...

Eshref Vishi: Unë e çmoj punën që është bërë nga në punën profesionale nga përbërja e kaluar e KQZ-së në hartimin e këtij plani. Vet kam qenë pjesë e shqyrtimit dhe miratimit të planit strategjik 2015-2018, dhe shumë aktivitete kanë ngelë pa fajin e KQZ-së, përkatësisht edhe të Sekretariatit duke marrë parasysh edhe zgjedhjet në këtë periudhë kohore që kanë ndodhur, sidomos vitin e kaluar që ka qenë i gjithë viti në proces zgjedhor, por unë mendoj se raportimi që duhet të bëhet mbi bazën e zbatimit të këtij plani, është i pa arritshëm! Është i pa arritshëm për dy arsye: një, zbatimi fillon tre muaj me vonesë, dhe dy, ka shumë aktivitete...! Për mendimin tim, zbatimi mbetet në pikëpyetje...

Valdete Daka: Sa për informatë, u përmenden raportimet ligjore, është e vërtetë që ato janë aktivitete edhe ato figurojnë këtu, është e domosdoshme që të vendosen në plan të punës sepse ne, kemi obligim t'i realizojmë...Kështu që, një numër i madh i këtyre aktiviteteve janë realizuar, nëse nuk kemi ndonjë zgjedhje në ndonjë komunë tjetër, mendoj që shumicën e këtyre aktiviteteve do të i arrijmë...

Sami Kurteshi: Është mirë të shohim cila është gjendja, çka është identifikuar, çka duhet të kryejmë si punë, çka është për të përmirësuar...Po çështja tjetër është se ku janë objektivat: hyjnë nuk hyjnë objektivat, unë mendoj se nuk ka veprim pa objektiv. A janë afatgjatë apo strategjike, për sa vite – për pesë, për dhjetë nuk është me rëndësi...Mirë është t'i shohim edhe të i analizojmë...! Në instancë të fundit, çka kërkohet...? E kemi një plan me të cilin ne duhet të punojmë tërë vitin, dhe po kërkohet prej meje me miratuar diçka që nuk po e kuptojë...! S'është diçka për hatër...! Unë, pak më shumë ose pak më pak, unë duhet të punoj me këtë plan: në atë pjesë ku më takon mua si përfaqësues politikë...! Prandaj, ajo çka më mungon mua, është kjo...! Unë, jam i gatshëm ta shohë atë analizë, dhe e dyta, vërtetë bëni përpjekje që të realizohet... Për mua, është me rëndësi që objektivat dhe veprimet me u operacionalizue, dhe pastaj unë e di saktësisht se si do të bëhen dhe po ashtu, e di se pse po e votoj këto plan, s'ka asgjë tjetër...

Arianit Elshani: Edhe në mbledhjen e këshillit të operacioneve zgjedhore kemi pasur diskutim dhe debat lidhur me planin të punës të KQZ-së. Samiu, përmendi gjendjen e KQZ-së por, se çka është për mua ky plan...? Ne, këtë plan kemi mundur ta marrim edhe prej atyre që kanë qenë para nesh, gjë të cilën unë e kam bërë. Pra, jam konsultuar paraprakisht. Me informatat që i kam, them se ky plan i punës, është bërë kryesisht me inputet e përfaqësuesit e LVV-së. U përmenden këtu qëllimet, ndoshta qëllimet kanë ndryshuar për faktin e ndryshimeve të pozicioneve politike, ndoshta keni pasur qëllime tjera: pozicion tjera politike si opozitarë, dhe pozicione tjera politike si subjekt në qeveri! Nëse keni dëshirë me ba plan pune shkojmë në Prevallë, shkojmë dhe e fillojmë prej fillimit...! Në faqen 8, nëse e lexoni, i kemi më të detajuara operacionet, me synim aktivitetet zgjedhore të planifikuara me saktësi, specifikohen qartë qëllimet. Tjetra, duhet ta potencojmë faktin se KQZ, e ka një të metë që nuk e ka një plan strategjik të cilin neve, në bazë të këtij plani prej të cilit na kërkohet që të punojmë prej muajit mars mund të punojmë për 5 vite në vazhdimësi ku vendosim vizionin - qëllimin dhe objektivat që të arrihen brenda 5 viteve të mandatit, dhe pas kësaj sigurisht që mund të krijojmë plan të punës. Ne, nëse fillojmë ne që tani me projektua planin e punës ne na merr kohë nuk është punë që kryhet brenda një dite, një jave e as dy jave kërkon konsultim me të gjitha departamentet; Kalon një muaj e dy pastaj ne ku mbesim...? Deri në muajin maj mbesim pa plan pune, dhe nuk e dimë çfarë aktiviteti do ta fillojmë...! Këto gjëra kryhen

paraprakisht. E kam potencuar edhe më herët në komision...! E kemi parasysh që në mars, është i caktuar plani strategjik: të punojmë në te, dhe të angazhohemi dhe, e kemi më lehtë të punojmë në vitin 2021. Këtu ka trashëgimi, e ne nuk mund të bëjmë revolucion, nuk mund të vijmë sot dhe ta ndërrojmë, sot ka praktika, ka zakone, ka legjislacion që na obligon neve në një formë që të marrim në konsideratë...Ne, nuk mund të bëjmë ndryshime radikale të përhershme për ndryshim pozicioneve...

Sami Hamiti: Nuk ka asnjë në hartimin e planit të punës nuk janë përmendur inputet kanë qenë të antarëve që kanë qenë prezent. Ju kisha lut, është mirë si institucion i pavarur sa më pak të i përmendim partitë politike pasi një plan, do të bëhet...! Janë inputet, ka qenë i të gjithëve kontributi, se ne po flasim për një draft të aprovuar me të cilin, kemi qenë të njoftuar të gjithë dhe nuk mund të aprovoet prej fillimi. Këtë nuk e pranoj sepse, është një draft që është bërë, ka një përvojë dhe ka një praktikë, ka disa ligje...Se kemi pritur që do të ketë zgjedhje të jashtëzakonshme, jemi munduar që me të gjitha kërkesat të jenë reale...

Sami Kurteshi: Ne, jemi përfaqësues të partive politike, dhe mirë që e kanë dhënë atë kontribut, tani janë mbajtur zgjedhjet, në të vërtetë LVV ka fituar, po plani është plan, sepse ne një plan të aktiviteteve vjetore. Nuk është qëllimi me e ndryshue planin, por mua po më mungon një çështje: ku janë objektivat...? E dyta, unë kam nevojë për ndihmë se jam për herë të parë në KQZ ! Ju po thoni, e keni një analizë të asaj çfarë ka ngjarë dhe në bazë të cilit është ndërtuar ky plan. Unë, jam i disponuar me e pa: pse e kemi këtë plan, dhe të jem në rregull me ndërgjegjen time!

Valdete Daka: Nëse, e ke lexuar me vëmendje në rubrikën e dytë i ke qëllimin edhe në përshkrim edhe një çështje ne këtu e pranuar apo se pranuar këtë plan disa aktivitete duhet të i zhvillojmë patjetër sepse janë obligime ligjore si çdo institucion tjetër që i ka nëse ne fillojmë me diskutime politike kush qysh tek, ky plan nuk është politik...! Ky plan, është plan i institucionit të pavarur që merrret me organizimin e zgjedhjeve dhe që i kryen disa obligime që i ka me kushtetutë dhe me ligj, kurse këto nuk kanë të bëjnë fare as me parti politike. Ne, për çdo aktivitet nuk kemi bërë se, nuk kemi nevojë vetëm, e aty kur duhet të bëjmë, i kemi bërë analizat! Mos harroni që janë bërë disa aktivitete nga viti 2019 sepse, nuk kemi arritur t'i përfundojmë për shkak të zgjedhjeve që na kanë marr kohë prej 6 muajve: zgjedhjet parlamentare. Shumë aktivitete, vetëm janë bërë nga viti 2019. Mirëpo, ne e kemi obligim, e nëse ne presim një muaj, dy apo tre, neve na ikin këto aktivitete të cilat i kemi paraparë të i zhvillojmë në muajin mars e prill, dhe deri në qershor. Por, edhe ky plan si i këtillë, neve na duhet patjetër. Ju sugjeroj që ne ta votojmë...

Alim Rama: Ju po kërkon ta votojmë një plan pa analizë, ne nuk kemi dokumentacion i cili, na e shpjegon këtë plan...

Valdete Daka: Për cilin aktivitet po do me ditë, ne nuk mundemi për çdo aktivitet me dhënë analizë. Të gjithë ata që kanë qenë para jush, nuk e kanë aprovue rastësisht. Ata para jush, e kanë analizua, shqyrtua dhe, e kanë votue...

Ibrahim Selmanaj: Nuk e pata ndërmend të flas, se kemi diskutua edhe në mbledhjen paraprake, por mendoj që më mirë është ta kemi një plan se mos të kishim fare...Konsideroj që duhet ta kemi një plan, duhet të orientojemi në këtë plan i cili, është i sqaruar...në rrugëtim e sipër kemi me hasë në probleme tjera dhe kemi me u ndal me probleme që janë të paparapara, por e kam përkrah edhe

pse nuk kemi pas asnjë përfaqësues si subjekt politik i aleancës. Pra, unë e përkrahi plotësisht duke e përmirësuar punën, dhe të nxjerrim afatet kohore dhe të vazhdojmë...

Yll Buleshkaj: Sa po e shoh, kemi një problem në metodologjinë e punës së KQZ, metodologjia me të cilën është hartuar plani strategjik por edhe plani i punës...! Nuk ka asnjë institucion në KQZ, që e ka më të mirë një plan...! Është hartuar plani, jemi pajtuar për t'i quar disa gjëra përpara, disa jemi pajtuar që objektivat t'i quajmë shtylla strategjike. Në faqen 8, i kemi shtyllat ku shpjegohen secila çka mund të arrijmë, secili aktivitet kontribon në njërin nga këto objektiva përshkrimi është i qartë. Për secilin aktivitet, është edhe qëllim pse po bëhen...! Ky raport, është punuar në atë stil që ne, jemi pajtuar, i ka të gjitha elementet që duhet ti ketë një plan vjetor. Qëllimi i tij, është që të na ndihmojë të orientohemi në burimet më të mira për të arritur këto qëllime, e nëse ju pajtoheni që të mos kemi plan, është tjetër gjë!

Në vazhdim, z. Buleshkaj, shpjegoi disa prej aktiviteteve të zhvilluara, disa të tjera që do të zhvillohen, gjithnjë duke arsyetuar nevojën për të pasur një plan pa të cilin, nuk mund të ecet më tutje.

Eshref Vishi: Ne, jemi në shqyrtimin dhe miratimin e një dokumenti që është i rëndësishëm së veçantë. Ne si anëtarë, kemi të drejtë të bëjmë pyetje dhe të kërkojmë sqarime. Unë, nuk pajtohem me ushtruesin e detyrës së sekretarit që, kjo është çështje e stilit dhe metodologjisë. Ne, e konsiderojmë vetën pjesë të KQZ-së: nëse del mirë është meritë edhe e jona, e nëse del keq, ne prapë kritikohemi për punën që nuk e kemi bërë suksesshëm në kuptim të realizimit dhe zbatimit të planit! Nuk po kërkojmë ndryshim të planit, nuk po kërkojmë që t'i hyjmë planit edhe një herë prej A-ZH, ne thjeshtë po kërkojmë sqarime: çfarë përmbajtje ka, dhe e dyta, të korrigjohet aq sa mundet..

Valdete Daka: Me qenë se po thua kërkojmë korrigjime: a mund të na tregoni se, cili është saktësisht ai korrigjim në përgjithësi! Po flitet për planin në përgjithësi, nëse ke ndonjë kërkesë eksplicite? Unë i shënova se çka thatë! Ke kërkuar që raportimet ligjore mos të hyjnë, e ato duhet patjetër të jenë pjesë e planit. Ti ke qenë pjesë e KQZ-së edhe më herët, nuk është hera e parë që po e aprovon planin. Por, ky plan ndryshon shumë pak prej atij plani që e ke aprovuar në 2016...

Debati, u zhvillua më tej rreth planit. Anëtarët e KQZ-së, në fund në bazë të rekomandimit të KOZ-it, u dakorduan që me 8 vota për dhe 2 abstenime, ta aprovojnë Planin e Punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Këshillave të Vendvotimeve për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës

Alim Rama: KOZ, ka shqyrtuar kërkesën në bazë të Sekretariatit – Departamentit të Koordinimit të Terrenit, dhe ne, paraprakisht kemi marrë raportin dhe emrat e përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve. Këshilli, e ka aprovuar raportin dhe, ne i rekomandojmë KQZ –së për aprovim...

Valdete Daka: A ka dikush vërejtje rreth emrave të përbërjes së këshillave të vendvotimeve...?

Anëtarët e KQZ-së, unanimisht aprovuan emërimin e këshillave.

5. Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Pejë dhe Suharekë:

Arianit Elshani: Këshilli për Çështje Ligjore në kuadër të KQZ-së, ka shqyrtuar kërkesën për zëvendësimin e zyrtarëve komunal në Pejë dhe në Suharekë, dhe me shumicë votash meqë, edhe janë shqyrtuar të gjithë filtrat, dhe i rekomandon KQZ-së aprovimin e këtyre zëvendësimeve.

Valdete Daka: Kush është për që Driton Sylqa të emërohet anëtarë në Kuvendin Komunal të Pejës nga subjekti politik Alternativa duke e zëvendësuar z. Reshat Nurboja. Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim për zëvendësim të anëtarit të kuvendit komunal.

Valdete Daka: Kush është për që znj. Afërdita Morina të emërohet anëtare në kuvendin komunal në Suharekë nga subjekti politik AAK, duke e zëvendësuar zonjën Vlora Neziri... ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim për zëvendësim të anëtarit të kuvendit komunal.

6. Të ndryshme !